



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.10.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:20 dhe mbaroi në orën 12:27.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aeksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Pasi verifikohet prezenca e anëtarëve të Këshillit, fillon mbledhja për trajtimin e çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se ditën e sotme kanë mbërritur 4 kërkesa që kanë karakter tepër urgjent 2, në lëndë penale nga Gjykata e Apelit Korçë, dhe 2 në lëndë penale nga Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Fillimisht trajtohet relacioni për Gjykatën e Apelit Korçë.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 2 çështje, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, si i përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, i caktuar me shortin e datës

¹ Procesverbal i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

12.10.2020, për gjykimin ditën e sotme të disa çështjeve tepër urgjente në Gjykatën e Apelit Korçë, z.Gramoz Levanaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit.

Më tej trajtohet relacioni për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Gjyqtarët për 2 çështje gjyqësore të veçanta, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes nr. 1 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje, konkretisht: z. Artur Kalaja.

Në shortimin e çështjes nr. 1 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: znj. Valdete Hoxha.

Gjyqtarët që plotësojnë kriteret janë: Artur Kalaja - Gjykata e Apelit Tiranë; Astrit Kalaja - Gjykata e Apelit Shkodër; Anita Mici - Gjykata e Apelit Durrës; Dritan Banushi - Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Enton Dhimitri - Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Edlira Petri - Gjykata e Apelit Tiranë; Genti Shala - Gjykata e Apelit Tiranë; Irena Brahimi - Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Margarita Buhali - Gjykata e Apelit Vlorë; Miranda Andoni - Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Ridvan Hado - Gjykata e Apelit Tiranë; Valdete Hoxha - Gjykata e Apelit Tiranë.

Ndërkohë, nuk plotësojnë kriteret, pavarësisht se kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, zoti Asim Vokshi dhe Elona Toro, pasi nuk kanë të paktën 5 vjet

përvojë në çështje penale, sikurse është informuar në vijimësi sa i përket kategorisë së këtyre gjyqtarëve.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Astrit Kalaja.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Artur Kalaja.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor